



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.03.2021, ora 12.00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit për Ekonominë dhe Financat, datë 11 mars 2021.

2. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i projektligjit “Për propozimin e projektligjit “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë “Bechtel International”, INC., për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës””

3. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr.1 në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga ministria e bujqësisë dhe zhvillimit rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH – Shqipëri, llogari bashkëpunimi”

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Roland Xhelilaj, Ylli Shehu, Arben Elezi, Artur Roshi, Edlira Hyseni, Xhevit Bushaj.

Mungojnë:

Vullnet Sinaj, Reme Lala, Korab Lita, Eljo Hysko, Suzana Topi.

Të ftuar:

Belinda Balluku – Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë
Viola Haxhiademin - Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e
Infrastrukturës dhe Energjisë
Enea Karakaçi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Mimoza Dhëmbi – Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në
Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Anduena Hoxha – Përgjegjëse sektori në Drejtorinë e Koordinimit
të ndihmës së huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Ermira Gjec - Zëvendesminister e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Alban Mesonjesi - Drejtor i Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit
Rregullator në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Elisa Teneqexhi – Drejtoreshë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në
Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Alma Baze - Drejtoreshë drejtorie në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit
Elton Orozi – Specialist në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

HAPET MBLEDHJA

Anastas Angjeli – Përshëndetje të gjithëve!

Sot zhvillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë me këtë rend dite:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit për Ekonominë dhe Financat të datës 11 mars 2021.

Së dyti, kemi shqyrtimin në cilësinë e komisionit përgjegjës të projektligjit “Për propozimin e projektligjit “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë “Bechtel International”, INC., për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës””.

Relator jam unë.

Së treti, shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr.1 në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH – Shqipëri, llogari bashkëpunimi”.

Relatore është Blerina Gjylameti.

Duke ju falënderuar të gjithëve dua t’ju bëj me dije se gjithashtu (*nuk kuptohet*)...për të dyja marrëveshjet përfaqësuesit e qeverisë nga të dyja ministrinë.

Për çështjen e parë përfaqësuese nga është ministrja Balluku, kështu që para se të fillojmë shqyrtimin e projektligjit “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë “Bechtel International”, INC., për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës”” fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që është miratimi i procesverbalit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat datë 11 mars 2021.

Në postën elektronike ju është vënë në dispozicion i gjithë procesverbali.

A keni ndonjë vërejtje, apo ndonjë sugjerim?

Nuk ka.

Ju lutem votoni kush është dakord me miratimin e procesverbalit të mbledhjes! Ngrini dorën!

Faleminderit të gjithëve!

Kalojmë në çështjen e dytë.

Zonja Balluku, më dëgjoni?

Viola Haxhiademi – A mund të presim edhe pak, kryetar, se zonja Balluku është duke ardhur?

Anastas Angjeli – Dakord, presim zonjën Balluku, që të aksesojë.

Më falni, për këtë ndërprerje!

Lajmërojeni zonjën Balluku, ju lutem!

Belinda Balluku - Përshëndetje!

Kërkoj ndjesë për vonesën, kryetar, por nga takimi në takim...

Anastas Angjeli - Dakord. Fillojmë, atëherë.

Zonja Balluku, fjala për ju.

Belinda Balluku - Përshëndetje të gjithëve!

Sigurisht, ky projektligj është mjaft i rëndësishëm për ne, pasi është projektligji për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me partnerin strategjik Bechtel International.

Nga Komisioni i Ekonomisë duam që ky projektligj të kalojë për miratim në seancën e ardhshme, duke qenë se tashmë i kemi kryer të gjithë hapat paraprakë me kompaninë Bechtel, ashtu siç ju e dini, bazuar në marrëveshjen ekonomike të firmosur ndërmjet qeverisë shqiptare dhe Departamentit Amerikan të Shtetit më 2 tetor të vitit të kaluar.

Po bëj një përmbledhje të projektligjit.

Projektligji ka të bëjë me kontratat, pasi kemi propozuar dy kontrata, të cilat do të lidhen në dy faza të ndryshme.

Kontrata e parë është midis KESH-it dhe Bechtel International për sa i përket të gjithë pjesës së parë, pra pjesës paraprake, ku përfshihen të gjitha aktivitetet që do të përmend më poshtë, siç janë: matja topografike dhe studimet hidrologjike në mbështetje të zhvillimit të projektimit; studimet e inspektimeve gjeoteknike në terren; zhvillimi i strategjisë për realizimin e projektit; rishikimi dhe finalizimi i vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social; përgatitja e projektit teknik, përfshirë përzgjedhjen e furnitorit të turbinave, me qëllim preventivimin e kostove dhe të sasive, si dhe shërbime të tjera të dakordësuara, për të mundësuar ecurinë e zhvillimit të projektimit të hidrocentralit të Skavicës. Pra, kontrata e parë, e nënshkruar ndërmjet Bechtel International dhe KESH-it, si autoritet kontraktor, do të jetë kontrata që do të parapërgatisë terrenin, nëpërmjet studimeve dhe projekteve, për të kaluar më pas në kontratën e dytë. Kontrata në fazën e parë do të ketë këta hapa. BECHTEL do të negociojë dhe do të dakordësojë kushtet e kontratës brenda 30 ditëve kohë negociimi në përputhje me këtë pikë ose një periudhë më të gjatë të dakordësuar bashkërisht nga BECHTEL dhe nga Ministria

e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Tri ditë pune pas finalizimit të kushteve firmoset kontrata midis palëve, ndërkohë që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave kontratën e firmosur 3 ditë pune pas firmosjes.

Ndërkohë, kontrata e fazës së dytë ka të bëjë me negocimin për ndërtimin, projektin e detajuar dhe ndërtimin e një hidrocentrali të Skavicës në Kaskadën e Drinit nga kompania BECHTEL Internacional ose kompani bija, të cilat do të marrin përsipër këtë ndërtim.

Afatet e kontratës së dytë do të jenë të tilla: brenda 60 ditësh nga krijimi, mbi të gjitha, duhet krijuar një komision negociimi me vendim të Këshillit të Ministrave, ku do të ketë përfaqësues të korporatës elektronenergjetike, përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe përfaqësues të tjerë që do të përfshihen, do të sanksionohen në këtë vendim të Këshillit të Ministrave nga institucioni apo nga ministritë e tjera të përfshira. Brenda 60 ditësh nga krijimi i komisionit të negociimit do të fillojë negociimi dhe do të dakordësojmë kushtet e kontratës me BECHTEL për fazën e dytë, për projektimin dhe ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës ose brenda një afati më të gjatë, siç e kemi thënë në kontratën e parë, por, sigurisht, të dakordësuar mes palëve. Komisioni i negociimit të kontratës mund të asistohet nga një konsulent apo nga një grup konsulence, sigurisht, të përzgjedhur nga Avokatura e Shtetit, sipas të gjitha procedurave dhe rregullave në fuqi.

Kontrata e fazës së dytë do të nënshkruhet nga autoriteti i kontraktuar KESH brenda 3 ditësh pune nga data e finalizimit të kushteve të saj nga komisioni i negociimit.

Kontrata në fazën e dytë të projektit do të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe do të hyjë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të ligjit të miratuar nga Kuvendi.

Pas miratimit të kontratës me BECHTEL për projektimin dhe ndërtimin e HEC Skavicës, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë do të krijojë një njësi të veçantë të zbatimit të këtij projekti. Ministri cakton kryetarë dhe anëtarë të njësisë së zbatimit të projektit, ekspertë, inxhinierë, juriste dhe ekonomistë, që ndjekin zbatimin e kontratës bashkë me korporatën elektroenergjetike shqiptare. Paga e kryetarit dhe anëtarëve caktohet nga ministri, duke marrë për bazë pagën e drejtuesve të korporatës elektroenergjetike.

Ky është projektligji që kemi sjellë në komisionin tuaj, pasi ka kaluar miratimin e Këshillit të Ministrave. Shpresojmë të kemi mbështetjen tuaj, sepse është një nga investimet më të rëndësishme në sektorin elektroenergjetik shqiptar. Siç e dini edhe ju, Skavica nuk do të ketë një rëndësi të veçantë thjesht për prodhimin e sasisë energjetike, por për shkak të optimizimit që i bën Kaskadës së Drinit, duke rritur kapacitetet prodhuese edhe të tri

hidrocentraleve ekzistuese në këtë kaskadë, por edhe duke e zgjidhur një herë e mirë të gjithë problemin e përmytjeve në fushën e nën Shkodrës.

Faleminderit për vëmendjen!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Ministre!

Unë si relator, pa dashur t'i përsëris vlerat e këtij projekti, sidomos në fushën e investimeve në sektorin strategjik dhe ...*(Nuk dëgjohet)* dhe në sektorin energjetik, doja të theksoja që në fillim se projekti shqyrtohet nga Komisioni i Ekonomisë si komision përgjegjës dhe Këshilli i Ministrave e ka propozuar projektligjin bazuar në nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Gjithashtu, shqyrtimi bëhet në përputhje me kërkesat e nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Dua të theksoj si elementë të veçantë, përveç fazave që përmendi ministrja dhe rëndësisë që ka projekti, se ky projekt vjen në përputhje me të gjithë legjislacionin shqiptar. Gjithashtu, projektligji është vlerësuar edhe në raport me Kodin Zgjedhor dhe me situatën zgjedhore, ndaj nuk ka asnjë kundërshtim dhe asnjë problem me nenin 91 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen rregullat se si duhet të veprohet 4 muaj para zgjedhjeve në disa drejtime të ndryshme, ku pjesa e mbështetjes së sektorit strategjik, për shkak edhe të kohës që ka nisur projektligji, pra që në muajin tetor të vitit 2020, besoj dhe argumentoj se nuk ka lidhje fare. Prandaj, e gjithë procedura është konform Rregullores, legjislacionit dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Unë kam vetëm një pyetje dhe dy-tri sugjerime, të cilat do t'i reflektoj nen për nen për efekt të procedurave legjislative.

Pyetja ime është: a duhet të japin propozuesit e projektligjit një informacion të plotë për shoqërinë “*Bechtel International*” nëse e ka marrë statusin e investitorit strategjik, që është një procedurë e veçantë që jepet nga Komiteti i Investimeve Strategjike? Më pas për nene të veçanta do të bëjmë edhe ndërhyrjet përkatëse që të jemi në rregull me procedurën legjislative.

Faleminderit dhe ju ftoj ta votoni atë.

Po, zonja Ministre, a keni një përgjigje për statusin e investitorit strategjik nga Komiteti i Investimeve Strategjike në përputhje me ligjin për investimet strategjike për shoqërinë “*Bechtel*”?

Belinda Balluku – Kryetar, në këtë rast nuk kemi një aplikim për sa i përket statusit të investitorit strategjik, sepse, sigurisht, është e bazuar mbi marrëveshjen ekonomike të firmosur, siç e thashë edhe në fillim të fjalës sime, midis shtetit shqiptar dhe Departamentit Amerikan të Shtetit. Kështu që nuk kemi një status strategjik të investitorit, pasi investimi do të bëhet përmes fondeve të vendosura në dispozicion nga KESH-i për kontratën e parë dhe, ndërkohë, për kontratën e dytë ne po punojmë në bashkëpunim si me DFC-në, ashtu edhe me “*Bechtel International*” për gjetjen dhe sigurimin e financimit të huaj, i cili do të vijë në formën e

kredisë. Kështu që “Bechtel”-i ka formën e partnerit për sa i përket ndërtimit dhe nuk i duhet në këtë rast, bazuar në ligjin shqiptar, që të ketë edhe statusin e partnerit strategjik.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Ministre!

A ka kolegët ndonjë pyetje, vërejte apo diskutim?

Në qoftë se nuk ka, atëherë kalojmë në votim.

Votojmë në parim projektligjin.

Pro? Faleminderit! Abstenim? Nuk ka. Kundër? Nuk ka.

Dua të sqaroj se kudo ku përmendet fjala “Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë”, do të zëvendësohet me fjalët “ministra përgjegjëse për instruktuarën dhe energjinë”.

Jemi dakord? Abstenim? Kundër? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 1?

Pro? Faleminderit! Abstenim? Nuk ka. Kundër? Arturi kundër.

Miratohet.

Në nenin 2, pika 3, fjalia e dytë riformulohet si më poshtë: “Shpenzimet për mbulimin e kontratës së fazës së parë mbulohen nga Korporata Elektro-energjetike Shqiptare”.

Me këtë sugjerim, kush është dakord me nenin 2?

Pro? Faleminderit! Abstenim? Nuk ka. Kundër? Arturi kundër.

Miratohet.

Titulli i nenit 3 riformulohet si më poshtë: “Procedurat e negociimit të kontratës”.

Kush është dakord me nenin 3?

Pro? Faleminderit! Abstenim? Nuk ka. Kundër? Arturi kundër.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4?

Pro? Faleminderit! Abstenim? Nuk ka. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 5?

Pro? Faleminderit! Abstenim? Nuk ka. Kundër? Arturi kundër.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 6?

Pro? Faleminderit! Abstenim? Nuk ka. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Votojmë projektligjin në tërësi.

Pro? Faleminderit! Abstenim? Nuk ka. Kundër? Arturi kundër.

Miratohet.

Zonja Ministre, faleminderit!

Belinda Balluku – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, të gjithë anëtarëve të komisionit!

Faleminderit për mbështetjen dhe punën që kemi bërë së bashku gjatë kësaj periudhe!

Më bëhet qejfi që e mbyllëm me një projekt kaq të rëndësishëm për energjinë shqiptare dhe për të gjithë Shqipërinë.

Faleminderit shumë!

Anastas Angjeli – Forca, të negocioni sa më shpejt dhe të përfundojë sa më shpejt dhe të fillojnë punimet! Një histori e gjatë nga të gjitha qeveritë, por më në fund ia dolët.

Kryetar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.03.2021, ora 12.00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi ne cilësinë e komisionit përgjegjës i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr.1 në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga ministria e bujqësisë dhe zhvillimit rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH – Shqipëri, llogari bashkëpunimi”

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Roland Xhelilaj, Ylli Shehu, Arben Elezi, Artur Roshi, Edlira Hyseni, Xhevit Bushaj.

Mungojnë:

Vullnet Sinaj, Reme Lala, Korab Lita, Eljo Hysko, Suzana Topi.

Të ftuar:

Ermira Gjec - Zëvendesminister e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Alban Mesonjesi - Drejtor i Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Elisa Teneqexhi – Drejtoreshë e Konceptimit dhe Fizibilitetit te Projekteve në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Alma Baze - Drejtoreshë drejtorie në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Elton Orozi – Specialist në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Anastas Angjeli - Kalojmë në çështjen e dytë.

Faleminderit, zonja Ministre!

Kalojmë në çështjen e dytë!

Çështja e dytë është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes “Për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr.1 në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH – SHQIPËRI, llogari bashkëpunimi”

Përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë, siç e thashë, janë prezentë. Relatore është zonja Gjylameti.

Fillojmë me Ministrinë e Bujqësisë dhe atë të Financave.

Kush do ta marrë fjalën nga përfaqësuesit e qeverisë, ju lutem?

Kush e ka fjalën? Ermira, ju lutem!

Ermira Gjeçi – Po. Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë!

Ky projektligj që prezantojmë sot, ka si qëllim ndryshimin e marrëveshjes ekzistuese të bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në lidhje me instrumentin lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit BERZH-Shqipëri, llogari-bashkëpunimi.

Ky instrument e ka zhvilluar zbatimin e tij në vitin 2016, si një iniciativë e qeverisë shqiptare, në bashkëpunim të ngushtë me BERZH, e konkluduar me nënshkrimin e një marrëveshjeje më 11 janar 2016, ratifikuar me ligjin nr. 4, 2016, me qëllim mbështetjen e sektorit të agrobiznesit.

Qeveria shqiptare vendos në dispozicion të BERZH shumën prej 36 milionë euro, me qëllim mbulimin e riskut të kredive të këqija, deri në nivelin 20 %.

Aktualisht, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka vendosur në dispozicion të BERZH, që nga viti 2016, shumën prej rreth 15 milionë eurosh. Nën këtë instrument, BERZH

ka bashkëpunim me 5 institucione financiare pjesëmarrëse, siç janë: Fondi Besa, Procredit Bank, OTP Bank, Intesa San Paolo, dhe Raiffeisen Bank.

Nga fillimi i programit, institucionet partnere në këtë program kanë disbursuar rreth 6098 kredi, me një volum prej rreth 65, 2 milionë, të cilat janë injektuar direkt në sektorin e bujqësisë.

Sektorët kryesorë të volumeve të disbursuara janë agropërpunimi dhe bujqësia primare, me respektivisht 28, 4 % dhe 27 % të portofolit.

Rajonet kryesore janë: rajoni i Tiranës, me 18, 7 %, ndjekur nga Fieri me 17 %, Korça 16, 7 % dhe Lezha 11 %.

Në kuadër të bashkëpunimit të skemave të programit të parë, mund të themi se ky instrument ka mbuluar rreth 20 % të aplikimeve të fituesve, të cilët kanë lidhur kontrata me Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.

Gjatë vitit 2020, pavarësisht situatës së pandemisë, bankat partnere të këtij instrumenti, kanë vijuar me mbështetjen me financim të sektorit të bujqësisë, duke disbursuar rreth 18 milionë euro kredi të reja për fermerët dhe agrobizneset, kryesisht në sektorët e agropërpunimit dhe bujqësisë primare.

Gjatë këtij viti të vështirë, bankat nga ana tjetër kanë ofruar dhe lehtësira financiare në pagesat e kësteve për klientët, të cilët janë prekur nga efektet e COVID-19, me qëllim rimëkëmbjen e aktivitetit dhe përballimin e situatës së krijuar.

Gjithashtu, janë mbështetur edhe klientët fitues të skemave IPARD. Objekti i kësaj marrëveshjeje ndryshuese konsiston në tri pika.

Së pari, ka të bëjë me përfshirjen e sektorit të turizmit si përfitues i këtij instrumenti për një nivel kreditimi deri në 30 milionë euro, në kushtet kur ky sektor ka qenë i prekur nga pandemia Covid, si dhe duke e konsideruar si një sektor të rëndësishëm, kontribuues në ekonominë e vendit.

Së dyti, ka të bëjë me përfshirjen e stimujve financiarë për të dy sektorët, agrobiznesin dhe turizmin, pra shtohet edhe turizmi në nivelin 10% të vlerës së kredisë me qëllim rritjen e atraksionit të përfituesve, për të pasur akses për financim në këtë instrument dhe mbulimi deri në nivelin 20% të riskut të humbjes së kredive për të dy sektorët. Asistenca teknike që ka qenë edhe në marrëveshjen e parë vazhdon të qëndrojë.

Përveç kësaj ndërhyrjeje synohet lehtësimi i aksesit në financa të agrobizneseve shqiptare apo bizneseve në fushën e turizmit për të rritur kontributin në zhvillimin e mëtejshëm të të dy sektorëve.

Përmes mbështetjes së sipërmarrësve vendas me mekanizmin e ndarjes së riskut, linjave të kreditimit dhe stimujve financiarë në formë granti për investime ky program jo vetëm që do të jetë më atraktiv përmes mbështetjes së ofron, duke nxitur dhe përmirësuar investimet, por paralelisht ofron një mbështetje domethënëse për aplikantët që duan të aplikojmë për skemat në programin IPARD.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Gjeçi!

Fjalën e ka zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Projektligji që po shqyrtojmë sot ka të bëjë me vendim nr. 84, të vitit 2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin në parim për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr. 1 në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar të vitit 2016, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me Bankën Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit të sektorit të turizmit BERZH-Shqipëri, llogari bashkëpunimi”.

Ne e shqyrtojmë këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës. Sa i përket qëllimit, ai ka të bëjë me lehtësirat që ofrohen, pasi ky projektligj ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese dhe rivendosjen e marrëveshjes në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit, pra ndërmjet Republikës së Shqipërisë së përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim në lidhje me lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe të sektorit të turizmit BERZH-Shqipëri, llogari bashkëpunimi.

Kjo marrëveshje synon përmirësimin e aksesit dhe të mundësive të financimit në fushën e agrobiznesit dhe të turizmit, duke ofruar linja të dedikuara kredie për bankat shqiptare dhe institucionet jobankare mikrofinanciare dhe duke ndarë riskun e huadhënies.

Evidentoj faktin që BERZH-i ka themeluar lehtësimin e mbështetjes për agrobiznesin, për të siguruar linja kredie dhe pjesëmarrje të pafinancuar në ndarjen nga rreziku mbi bazën e portofolit për bankat dhe institucionet mikrofinanciare në Republikën e Shqipërisë për kreditimin e agrobizneseve lokale. Në këtë kuadër, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Financave dhe BERZH-i kanë hyrë në një marrëveshje bashkëpunimi, më 11 janar të vitit 2016, për të rregulluar krijimin dhe administrimin e një llogarie në lidhje me lehtësimin.

Duke qenë se mbështetja e sektorit të turizmit është një prioritet i Këshillit të Ministrave, ministritë dhe BERZH- i kanë rënë dakord të përfshijnë në këtë marrëveshje edhe

sektorin e turizmit në stimujt financiarë në lehtësimin, duke ndryshuar dhe rivendosur marrëveshjen origjinale. Lehtësimet që do të mbulohen nga kjo marrëveshje kanë të bëjnë me faktin që të gjitha institucionet financiare pjesëmarrëse, që operojnë në Shqipëri, kanë të drejtë të bashkohen me shërbimin e lehtësimit në bazë të respektimit të standardeve kreditore dhe integritetit të BERZH-it.

Sipas marrëveshjes, qeveria shqiptare vendos në dispozicion të BERZH-it një shumë totale prej 36 milionë eurosh. Gjatë periudhës 2016-2018 Ministria e Bujqësisë ka vendosur në dispozicion një shumë prej 15 milionë e 476 mijë e 578,48 euro. BERZH-i parashikon vënien në dispozicion deri në 100 milionë euro, shumë e cila pritet të mbështesë angazhimin deri në 180 milionë euro të nivelit total të huas, nga të cilat deri në 30 milionë euro në mbështetje të financimit të sektorit të turizmit.

BERZH-i do të vendosë në dispozicion mbulimin e rrezikut të humbjes së parë, nëse merr kontribute, në masën e kontributit të marrë nga ministritë. Lehtësimi do të bëhet nga këta komponentë: së pari, linja kredie për agrobiznesin dhe turizmin, që konsistojnë në linja kredie të pasiguruara, që do t'iu ofrohen institucioneve financiare pjesëmarrëse për huadhënie ndaj subjekteve të agrobiznesit dhe turizmit; së dyti, lehtësimi i agrobiznesit dhe turizmit për ndarjen e riskut, që konsiston në një pjesëmarrje të pafinancuar në një portofol, bazuar në instrumentin e ndarjes së riskut, që mbulon deri në 50% të shumës totale të një portofoli të kredive të papaguara të pranueshme të agrobiznesit dhe turizmit, në përputhje me një grup të paracaktuar kriteresh kualifikimi. Sipas kësaj strukture nënhuaja do të gjenerohet, vlerësohet, miratohet dhe disbursohet dhe monitorohet nga çdo institucion financiar pjesëmarrës në përputhje me politikat e tyre të kreditimit.

Sipas kësaj marrëveshjeje, çdo lehtësim për ndarje të riskut për agrobizneset dhe turizmin do të jetë një strukturë e hapur, që do të fillojë në një gjendje stok deri në 50% të portofolit të kredisë ekzistuese të agrobiznesit që përputhet me kriteret e përshtatshmërisë.

Institucionet financiare pjesëmarrëse do të angazhohen për të sjellë nën huë të përshtatshme për sektorin e agrobiznesit dhe turizmit, që arrijnë të paktën 2 herë shumën e gjendjes fillestare për një periudhë deri në 5 vjet. Kjo strukturë do t'iu mundësojë këtyre institucioneve financiare rritjen e portofolit të huave në sektorin e agrobiznesit dhe turizmit dhe të paktën 200% ose edhe më shumë të nivelit aktual deri në kohën e mbylljes së sistemit.

Këto dy komponentë janë plotësues dhe mund të vihen në dispozicion veçmas ose bashkërisht për çdo institucion financiar. Lehtësimi do të përfitojë, gjithashtu, nga tre komponentë shtesë, si: mbulimi i riskut për humbjen e parë, që mbulon respektivisht në rastin e linjave të kredisë së agrobiznesit dhe turizmit humbjen deri në 205 të shumës totale të

nënhuave të financuara me vazhdimin e linjave të kredisë të agrobiznesit dhe turizmit; së dyti në rastin e lehtësimit për ndarjen e riskut të agrobiznesit dhe turizmit humbjet deri në 20 të portofolit të nënhuave të pranueshme ndahen midis BERZH-i dhe institucionit financiar.

Sa i përket stimulit për investime për agrobizneset, që marrin pjesë në linjat e kredisë ose lehtësimin e ndarjes së riskut për agrobiznesin, subjektet që marrin hua për investime kapitale me një maturim prej të paktën 18 muajsh do të jenë të përshtatshme për të marrë një pagesë stimuluese në formën e një granti prej 10% të vlerës së huas, në varësi të verifikimit të suksesit të zbatimit të huas dhe investimit kapital nga konsulenti verifikues.

Atëherë, sa i përket asistencës teknike, e cila do të përbëhet në vetvete nga dy komponentë, si asistenca teknike specifike në sektorin e agrobiznesit dhe turizmit, e cila do të konsistojë në vlerësimin e problemeve të mundshme të sektorit që pengon aksesin për financim përmes analizës së portofolit ekzistues të institucioneve financiare, agrobiznesit dhe klientëve të rinj të synuar; shërbimet këshillimore ndaj huamarrësit në institucionet financiare dhe huamarrësve potenciale do të sigurohen nga BERZH-i; grupi mbështetja e turizmit të vogël për agrobizneset e turizmit që synojnë të lehtësojnë aksesin për njohuritë dhe hartimin e shërbimeve jofinanciare duke mbështetur SME-të, e lejueshme nga zonat që rrjedhin nga strategjitë; veprimet e menaxhimit të cilësive specifike për sektorin e agrobiznesit dhe turizmit.

Gjithashtu, vlerësimi i mësipërm do të ndihmojë për identifikimin e nevojave për hartimin e shërbimeve shtesë jofinanciare, specifike për sektorin e agrobiznesit dhe turizmit.

Sa i përket pikës së fundit, ngritja e kapaciteteve të institucioneve financiare përfituese për të mbështetur kapacitetet e tyre për të siguruar dhe kërkuar kredi në bazë të programit dhe për të promovuar këtë kredi në rajon.

Pa dashur të vazhdoj më tej në përmbajtje, e cila u përmend pak më parë nga zëvendësministrja, si dhe institucionet zbatuese të marrëveshjes, kemi edhe një pikë që është e rëndësishme, që ka të bëjë me atë që është në funksionin bazë të Komisionit të Ekonomisë, me efektet financiare. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit, ku qeveria shqiptare vendos në dispozicion të BERZH-it një shumë prej 36 milionë eurosh, sipas ndarjes së mëposhtme, ku Ministria e Bujqësisë do të vendosë në dispozicion në total 30 milionë euro, nga të cilat gjatë periudhës 2016-2018 ka disbursuar 15 milionë e 476, 578 euro.

Ministria e Mjedisit dhe Turizmit do të vendosë në dispozicion të BERZH-it në total 6 milionë euro. Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Mjedisit marrin përsipër planifikimin e tavaneve të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm dhe detyrimet përkatëse, që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

Për sa evidentova më sipër, duke vlerësuar se ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do të mundësojë përmirësimin e mundësive të financimit në fushën e agrobiznesit dhe turizmit, duke ofruar linja të dedikuara kredie për bankat shqiptare dhe institucionet jobankare mikrofinanciare, ju rekomandoj ta miratojmë atë.

Ju faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Të nderuar kolegë, ka pyetje? Nuk ka. Atëherë, ta kalojmë edhe këtë marrëveshje në votim.

Kush është pro në parim me këtë marrëveshje? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Një votë abstenim, zoti Roshi.

Miratohet.

Kalojmë te neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Një votë abstenim, zoti Roshi.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Një votë abstenim, zoti Roshi.

Miratohet.

Kalojmë në votimin e projektligjit në tërësi. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Një votë abstenim, zoti Roshi.

Miratohet.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

Kryetar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti